

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.


Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjës të institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit maj, 2025

Ekipi Tematik Teknik Antikorrupsion miraton Raportin e Monitorimit 2024, të zbatimit të strategjisë antikorrupsion 2024-2030

6.05.2025: Sekretariati Teknik pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit përfundoi së hartuari raportin e monitorimit vjetor 2024, të zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030. Rrjeti i Pikave të Kontaktit Antikorrupsion (Ekipi Tematik Teknik Antikorrupsion) u mbledh në takim konsultativ me fokus diskutimin dhe dakordësimin e draft-raportit vjetor të monitorimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030, përkatësisht, për vitin 2024. Raporti përmban të dhëna mbi zbatimin e masave të parashikuara për vitin 2024, arritjet, sfidat e hasura dhe rekomandime për përmirësim. Raporti përmban të dhëna statistikore, përshkrime të hollësishme mbi masat dhe aktivitetet e zbatuara si dhe vlerësime mbi ndikimin e strategjisë, të lidhura ngushtë me agjendën e integritetit evropian. Diskutimet e anëtarëve të Ekipit Tematik Teknik Antikorrupsion i dhanë rëndësi nivelit (përqindjeve) të përmbushjes së detyrimeve nga institucionet raportuese, mbi cilësinë e informacionit të dhënë dhe mbi efektivitetin e mekanizmave të ndjekjes së masave të ndërmarra. Rëndësia e rolit të Rrjetit të Pikave të Kontaktit Antikorrupsion, një instrument kyç për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe sigurimin e një procesi të qëndrueshëm, të koordinuar dhe të besueshëm të raportimit, ishte një tjetër tematikë e takimit. Në përfundim, raporti u miratua në mënyrë paraprake, për tu paraqitur në vijim pranë Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit në kuadër të paraqitjes së tij për miratim final nga Ekipi Tematik Antikorrupsion, në muajin qershor 2025.



Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit organizon trajnime për vlerësimin e riskut të korrupsionit

6 - 20.05.2025: Vlerësimi i riskut të korrupsionit, ky proces me rëndësi në ushtrimin e detyrave dhe kompetencave funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, ishte tematika e dy takimeve (sesione trajnimi) të dedikuara për përgatitjen e stafeve teknike të institucioneve publike që do jenë edhe ekspertët zbatues të metodologjisë së miratuar, përkatësisht. 5 trajnerët, punonjës të stafit kyç të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, të pregatitur dhe në kapacitet të plotë për të përcjellë zbatimin e metodologjisë, ofruan materiale shpjeguese shoqëruar nga dilema etike për diskutim.

Fillimisht (6.05.2025), procesi u shpjegua në një seancë gjysmë-ditore trajnimi për Koordinatorët Antikorrupsion pranë 26 autoriteteve publike, ku shtrin organizimin dhe funksionimin Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit. Koordinatorët Antikorrupsion pranë drejtorive të kadastrës, autoriteteve të arsimit, të shëndetësisë, të ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit, të prokurimeve publike, të tatimeve, të doganave, të shërbimeve sociale, të kontrollit ushqimor, të shërbimeve postare u njohën me ciklin e vlerësimit të riskut të korrupsionit që do të kryhet pranë tyre. Mbështetur në problematikat dhe proceset e punës më të riskuara dhe që paraqesin sektorët vulnerabël, cikli i vlerësimit të riskut i shpjeguar në metodologjimë e vlerësimit (miratuar me urdhrin nr.2, datë 22.04.2025) do të adresojë masat mitiguese të korrupsionit në këta sektorë. Roli i Koordinatorëve Antikorrupsion, si anëtarë të grupeve të punës pranë institucioneve të tyre do të mbështesë proceset dhe koordinojë ato, duke garantuar zbatimin e një prej objektivëve strategjikë në relevancë me Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Në vijim (20.05.2025), sesioni i trajnimeve të vlerësimit të riskut të korrupsionit u ofrua për ekipet teknike të 11 Ministrive të Linjës, dhe varësive të tyre. Institucione të pavarura kushtetuese, gjithashtu, u bënë pjesë e këtij sesioni në përputhje me kompetencat funksionale të tyre si Kontrolli i Lartë i Shtetit, ILDKPKI dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Trajnimi kishte për qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale për të kryer një vlerësim të mirëfilltë dhe të qëndrueshëm të riskut të korrupsionit, si një ndër mekanizmat kyç në parandalimin dhe luftimin e tij. Sesionet trajnuese trajtuan konceptet teorike dhe bazat metodologjike të vlerësimit të riskut të korrupsionit, si përkatësisht: qasja, hapat dhe strukturat e nevojshme për zbatim; dallimi ndërmjet vlerësimit të riskut të integritetit dhe vlerësimit të riskut të korrupsionit; llojet e ndryshme të vlerësimit të riskut të korrupsionit, si dhe përzgjedhjen e qasjes më të përshtatshme sipas kontekstit institucional; faza e planifikimit dhe përgatitjes për procesin e vlerësimit të riskut, përfshirë përfshirjen e aktorëve përkatës dhe strukturimin e grupit të punës. Sesionet adresuan edhe rolin praktik dhe interaktiv, përmes ushtrimeve dhe analizave konkrete. Cikli i menaxhimit të riskut dhe mënyrat e integritetit të tij në punën e përditshme institucionale shoqëruar nga ushtrime praktike dhe analiza të rasteve për fushat e përbashkëta dhe të veçanta të institucioneve pjesëmarrëse u trajnuan gjithashtu.

Seancat e trajnimit u mbështetën nga ekspertiza teknike e projektit EU4GG të delegacionit të Bashkimit Evropian, dhe organizatës Qendra ALTRI.



Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në ndjekje të rasteve për korrupsion në administratën publike


1 - 30.05.2025: Aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në fushën e hetimit dhe verifikimit administrativ vijon me verifikimin e rasteve (ankesa të ardhura nga indicie korrupsioni të marra nga stafi i Drejtorisë së Hetimit dhe ato të Koordinatorëve Antikorrupsion). Gjatë muajit maj 2025 është propozuar 1 masë administrative dhe janë dhënë 3 rekomandime për autoritete publike dhe punonjës të tyre që nuk kanë kryer si duhet detyrimet publike. Këto masa janë adresuar për punonjës të Drejtorive Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Rekomandimet kanë patur në fokus kryesisht përmirësimin e zbatimit të ligjit, rishikimin dhe përditësimin e kuadrit rregullator të brendshëm, garantimin e ofrimit të shërbimeve publike brenda afateve ligjore, si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara për qytetarët dhe publikun. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit vijon të jetë në komunikim të vazhdueshëm me institucionet përkatëse për të ndjekur nga afër ecurinë e zbatimit të këtyre masave dhe rekomandimeve, duke siguruar një monitorim efektiv dhe mbështetje për përmirësimin e mëtejshëm të proceseve administrative dhe shërbimeve ndaj qytetarëve. Gjithashtu, gjatë këtij muaji janë përfunduar 16 raste për të cilat ankuesit kanë marrë zgjidhjet përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit asiston përgatitjen e Planit të Integritetit në Kadastrë

7 - 29.05.2025: Agjencia Shtetërore e Kadastrës po kryen vlerësimin e riskut të integritetit në bashkëpunim të ngushtë me stafin teknik dhe ekspertizën e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit. Ky proces ka për qëllim vlerësimin e riskut të integritetit në nivel drejtorie dhe njësie funksionale, si dhe identifikimin e masave parandaluese për minimizimin e risqeve që paraqet veprimtaria e tyre. Gjatë muajit maj 2025 janë zhvilluar 6 takime të dedikuara me disa struktura kyçe të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, përmenden: Drejtorinë



e Auditimit të Brendshëm, Drejtorinë e Apelimit dhe Bashkëqeverisjes, Drejtorinë e Kadastrës dhe Monitorimit të Titujve të Pronësisë, Drejtorinë e Kompesimit dhe Monitorimit të Regjistrimit Fillestar, Drejtorinë e Financës si edhe Drejtorinë e Investimeve dhe Shërbimeve. Përmes diskutimeve të strukturuar dhe pyetësorëve të posaçëm, është mbledhur informacion mbi funksionimin e brendshëm i këtyre njësive (zyra dhe sektorë) për të evidentuar proceset me risk të lartë dhe mangësitë në mekanizmat aktualë të integritetit. Ky proces bazohet në qasjen e vetëvlerësimit institucional dhe synon ndërtimin e planeve konkrete dhe të matshme për rritjen e integritetit në punën administrative. Procesi do të vijojë edhe përgjatë muajit qershor, dhe do të finalizohet me hartimin e një plani integriteti në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për vitet 2025-2027.



Studentët, bashkëpunëtorët më të mirë në luftën kundër korrupsionit

21, 27 - 29.05.2025: Edukimi dhe ndërgjegjësimi për luftën kundër korrupsionit mbeten “guri i themelit”, për një shoqëri të drejtë dhe mbështetur tek parime e ligjit dhe të zbatimit të tij. Projekti “Fuqizimi i studentëve mbi integritetin: Lufta kundër korrupsionit në arsimin e lartë”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe SELDI.net, dhe nisur zbatimimi nga Qendra ALTRI, riktheu ekspertët e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në auditorët universitarë. Tre orë leksioni të hapura me studentë dhe pedagogë të fakulteteve të drejtësisë në vend, u zhvilluan përgjatë muajit maj 2025.

Orët e leksioneve të hapura, i pari (21.05.2025), u zhvillua në auditorin e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Roli proktiv i të rinjve në luftën kundër korrupsionit, rëndësinë e kultivimit të një kulture integriteti në arsimin e lartë, si dhe nevojën për të promovuar mekanizma efektivë të raportimit dhe ndërgjegjësimi qytetar, u ndanë nga ekspertët e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, së bashku me ekspertin, pedagogun, Ervin Karamuço. Një fokus i veçantë iu kushtua hetimit administrativ, si një nga instrumentet thelbësore të drejtësisë, për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të korrupsionit në institucionet publike, përfshirë ato arsimore. Studentët shtruan pyetje dhe dilema për trajtim, si shprehje interesi për trajtimin e rasteve kur administrata publike duhet të ndjekë partneritetit shoqëri-administratë.



Leksioni i dytë i hapur (27.05.2025), u zhvillua në auditorin e Kolegjit Universitar “Marin Barleti” në Tiranë. Integriteti në fokus, parashikimet e Strategjisë Ndersektoriale Kundër Korrupsionit, 2024 - 2030, roli i të rinjve studentë në njohjen e masave kundër korrupsionit, rëndësia e zbatimit të saj në praktikë, veçanërisht në sistemin arsimor, përmes aktiviteteve që synojnë forcimin e integritetit, transparencës dhe llogaridhënies në institucionet publike, u promovuan për 60 minuta. Studentët dhe pedagogë të tyre ngritën pyetje për strukturat e hetimit, të sinjalizimit dhe raste kur Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit bashkëpunon me organet ligjzbatuese, të policisë dhe prokurorisë.

Ora e tretë e leksionit të hapur (29.05.2025), u mbajt në auditorin e Universitetit “Aleksandër Moisiu” në Durrës. Studentët e shkencave juridike dhe politike, u njohën më nga afër me funksionet e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, procesin e trajtimit të denoncimeve, si dhe rëndësinë e përfshirjes së tyre aktive në mbrojtjen e integritetit institucional. Studentët e Durrësit ritakohen me informacionet e luftës kundër korrupsionit edhe në këtë vit akademik, duke treguar interes të rritur për të dhëna dhe trajtime rastesh hetimi administrativ ku sektori mbeti arsimi i lartë.



Aktivitetet mësimore të orëve të hapura, u realizuan në bashkëpunim me Qendrën ALTRI, me tematikë forcimin e partneritetit për edukimin dhe fuqizimin e studentëve në drejtim të transparencës, etikës dhe luftës kundër korrupsionit në arsimin e lartë. Projekti rivjen si një iniciativë bashkëpunimi, me këtë grup interesi, të rinj dhe staf akademikë, që duan të zhvillojnë ekspertizën e tyre në hartimin e politikave antikorrupsion, promovimin e interesit publik dhe qytetar dhe ndjen e hetimin administrativ për raste të dyshuara korrupsioni apo shpërdorimi detyre.

Lufta kundër korrupsionit, bëhet pjesë e kurrikulës të Akademisë së Integritit Evropian dhe të Negociatave

17.05.2025: Kuadri ligjor dhe institucional në luftën kundër korrupsionit, u bë pjesë e kurrikulës së programit të Akademisë së Integritit dhe Negociatave për vitin 2025. Trajtime të politikave që përmban Strategjia Ndersektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030 si përkatësisht parandalimi-ndëshkimi-ndërgjegjësimi dhe parashikimet e saj me masat dhe aktivitetet konkrete për të vendosur parimet e një shteti bazuar te ligji dhe e drejta, ishte sesioni i dytë i punimeve të ditës hapëse të programit. Pjesëmarrësit e akademisë, studentë, punonjës së administratës publike, sektor privat, kërkues dhe stafe të shoqërisë civile ndoqën këtë sesion duke u interesuar se si kuadri instituional i antikorrupsionit ndjek parimet e zbatimit të ligjeve, planifikon dhe harmonizon kuadrin legjislativ dhe garanton mekanizimin e monitorimit efikas të strategjisë. Reforma në drejtësi, tashmë pasohet nga reforma antikorrupsion ku ligji, kuadri institucional dhe ndërveprimi priten të jenë së bashku instrumentet udhëheqëse të integritit evropian të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

